



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
SEKRETARIA**

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më ____ .11.2020

**Për mbledhjen Nr. 44, datë 19.11.2020, ora 14:00
Të Bordit të ERE-s**

Në zbatim të (i) nenit 13 të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; të ndryshuar, (ii) Rregullores bazë së Organizimit dhe Funkcionimit të Entit Rregullator të Energjisë të miratuar me Vendimin e ERE-s Nr. 144/2019 dhe (iii) nenit 11 të “Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s” miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr.96, datë 16.07.2016, (iv) Aktit Normativ të Këshillit të Ministrave Nr. 8, datë 24.03.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në aktin normativ nr. 3, datë 15.03.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të vecanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID – 19”, të ndryshuar, njoftojmë se **ditën e Enjte, datë 19.11.2020, ora 14:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 44 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

- 1-** Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Seman Sunpower” sh.p.k, për transferim të asetëve (vendosje hipoteke) në favor të “Intesa Sanpaolo Bank” sh.a.
- 2-** Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Wenerg” sh.a. për marrjen e autorizimit të ERE-s për barrësimin e 100% të aksioneve të shoqërisë në favor të bankës OTP

Në zbatim të pikës 1 të Urdhërit të kryetarit të ERE-s nr. 53, datë 11.03.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-2019”; Urdhërit nr. 53/1, datë 24.03.2020 “Për një ndryshim në urdhërin nr. 53, datë 11.03.2020”, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore” dhe Urdhërit nr. 53/2 datë 01.06.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore gjatë gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga Covid-19, mbledhja nuk do të jetë e hapur për publikun.

**KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI**